

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Data: 08.07.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin e 11.500 njësive të reja të ullirit” në njësitë administrative: Topojë, Patos, Ruzhdie, Qendër, Kutë, Fratar, Allkaj, Bubullimë, Fier- Shegan, Krutje, Kolonjë, Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Rremas në qarkun Fier dhe Shushicë, Kotë, Himarë, Vlorë dhe Selenicë në qarkun Vlorë” **e ndarë në dy lote:**

Loti 1: “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin në programin “Kadastra e Ullirit” e 6000 (gjashtë mijë) njësi të reja të ullirit” në njësitë administrative: Topojë, Patos, Ruzhdie, Qendër, Kutë, Fratar, Allkaj, Bubullimë, Fier- Shegan, Krutje, Kolonjë, Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Rremas në qarkun Fier.

Loti 2: “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin në programin “Kadastra e Ullirit” e 5500 (pesë mijë e pesëqind) njësi të reja të ullirit” në njësitë administrative: Shushicë, Kotë, Himarë, Vlorë dhe Selenicë në qarkun Vlorë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Shërbime rregjistrimi 79995200-7

KOHEZGJATJA E KONTRATËS: Deri me dt.15.12.2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 23,545,424 (njëzet e tre milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e njëzet e katër) **lekë pa TVSH.**

Kjo vlerë konvertohet në 251,070.84 euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 08/07/2026 është 93.78 lekë.

- **Loti 1:** “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin në programin “Kadastra e Ullirit” e 6000 (gjashtë mijë) njësi të reja të ullirit” në njësitë administrative: Topojë, Patos, Ruzhdie, Qendër, Kutë, Fratar, Allkaj, Bubullimë, Fier- Shegan, Krutje, Kolonjë, Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Rremas në qarkun Fier”, me fond limit: **12,279,666** (dymbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lek pa tvsh,** ose **130,941.20** (njqind e tridhjetë mijë e nenteqind e dyzet e një pikë njëzet) **Euro pa TVSH**
- **Loti 2:** “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin në programin “Kadastra e Ullirit” e 5500 (pesë mijë e pesëqind) njësi të reja të ullirit” në njësitë administrative: Shushicë, Kotë, Himarë, Vlorë dhe Selenicë në qarkun Vlorë”,

me fond limit: **11,265,758** (njëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) **lek pa tvsh** ose **120,129.64** (njeqind e njezet mije e njeqind e njezet e nente pike gjashtedhjetë e kater) **Euro pa TVSH**.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 08/07/2026 është 93.78 Lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti Kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar. Specifikimet teknike dhe perlllogaritja e fondit limit janë hartuar dhe percjelle ne OBP, nga Autoriteti Kontraktor Perfitues (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë)

LOTI 1: “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin në programin “Kadastra e Ullirit” e 6000 (gjashtë mijë) njësi të reja të ullirit” në njësitë administrative: Topojë, Patos, Ruzhdië, Qendër, Kutë, Fratar, Allkaj, Bubullimë, Fier- Shegan, Krutje, Kolonjë, Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Rremas në qarkun Fier.

Autoriteti Kontraktor ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit duke u bazuar në analizën teknike të objektit të kontratës, vlerën e fondit limit, afatin e realizimit, kompleksitetin e shërbimit, shtrirjen territoriale dhe rezultatet që synohen të arrihen.

Objekti i kontratës nuk përbën një shërbim administrativ të zakonshëm, por një aktivitet teknik dhe profesional që përfshin identifikimin në terren të njësive të ullirit, evidentimin e koordinatave gjeografike, përpunimin e informacionit, verifikimin teknik, administrimin e të dhënave gjeohapësinore dhe regjistrimin e tyre në sistemin "Kadastra e Ullirit".

Shërbimi do të realizohet në 16 njësi administrative të Qarkut Fier, me evidentimin e 6000 njësive të reja të ullirit, çka kërkon organizim paralel të ekipeve në terren, koordinim teknik, kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së të dhënave dhe respektim të afateve kontraktore.

Për këtë arsye, kriteret e vendosura janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e saj.

Kriteret janë hartuar në mbështetje të: Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar; parimeve të proporcionalitetit, mosdiskriminimit, transparencës dhe konkurrencës, të parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023,2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontrates, per Lotin e pare.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit te pare, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur

janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit të Lotit të pare.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara

dhe duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

Kontrata parashikon evidentimin e 6000 njësive të reja të ullirit në një territor të gjerë, me karakteristika të ndryshme topografike dhe administrative. Për këtë arsye, realizimi i kontratës kërkon kapacitete organizative dhe teknike të provuara më parë.

Paraqitja e pervojës së ngjashme të realizuara si me sektorin publik ashtu edhe me sektorin privat garanton respektimin e parimit të trajtimit të barabartë dhe zgjeron mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

8. PROJEKTUES GJEODET

b- Rilevime inxhinierike kadastrale

c- Sistemet GIS

e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë liçencën profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore. Kategoria e kërkuar e liçencës është kërkuar bazuar në natyrën e shërbimit të kërkuar dhe termave të referencës të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor përfitues e cila shërben për të rritur besueshmërinë dhe sigurinë që produkti final do të jetë në përputhje me kërkesat dhe objektin ku konkretisht kërkohet: Identifikimi në terren i njësive të ullirit, përcaktimi i pozicionit të tyre gjeografik, administrimi i koordinatave, përpunimi i informacionit gjeohapësinor dhe regjistrimi i të dhënave në sistemin "Kadastra e Ullirit". Këto procese kërkojnë njohuri të specializuara në fushën e gjeodezisë, hartografisë, fotogrametrisë dhe sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).

- Nënkatëgoria "Rilevime inxhinierike kadastrale" është e domosdoshme për evidentimin dhe përcaktimin korrekt të pozicionit të objekteve në terren.
- Nënkatëgoria "Sistemet GIS" lidhet drejtpërdrejt me përpunimin, administrimin dhe integrimin e të dhënave gjeohapësinore në platformën "Kadastra e Ullirit", e cila funksionon mbi bazën e sistemeve të informacionit gjeografik.
- Nënkatëgoria "Projektim fotogrametrik dhe hartografik" është e nevojshme për interpretimin dhe përpunimin e materialeve kartografike dhe ortofotove që përdoren gjatë procesit të identifikimit dhe verifikimit të njësive të ullirit.

2.3.3 Operatori/ët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për muajin e fundit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik

Per stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- Kontraten individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i procedurës nuk konsiston vetëm në evidentimin fizik të njësive të ullirit, por përfshin edhe aktivitete të specializuara të karakterit gjeodezik dhe gjeohapësinor, të cilat kërkojnë drejtim teknik nga një specialist i fushës. Për këtë arsye, vlerësohet se prania e të paktën një inxhinieri të kësaj fushe është kusht minimal dhe proporcional me objektin e kontratës. Kërkesa që ky specialist të jetë i punësuar dhe të paraqitet kontrata e punës, diploma dhe CV-ja synon të garantojë disponueshmërinë reale të ekspertit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Inxhinieri i diplomuar në një nga fushat e mesiperme garanton dhe është përgjegjës i organizimit teknik të punimeve; metodologjisë që do të ndiqet për mbledhjen e të dhënave; do të koordinojë punën e ekipeve në terren; etj kontrollin teknik të matjeve; kontrollin e cilësisë së të dhënave përpara regjistrimit në sistemin "Kadastra e Ullirit" etj.

2.3.4. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontratë pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- 3 (tre) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik
- 1 (një) specialist të pajisur me certifikate të trajnimit kombëtarë ose ndërkombëtarë në programet GIS ose programe ekuivalente . Certifikimin e kërkuara mund të zotërohen edhe nga stafi i sipërcituar.
- 4 (katër) specialiste agronomë

Per stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- Kontraten individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV.

Ne rast se stafi i mesiperm do te jete i OE pjesemarres, duhet të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i kontratës përfshin evidentimin e 6000 njësive të reja të ullirit, të shpërndara në 16 njësi administrative, me distanca të konsiderueshme ndërmjet tyre dhe me karakteristika të ndryshme të relievit. Për të respektuar afatin e percaktuar nga AK perfituese, është e domosdoshme që aktiviteti të zhvillohet njëkohësisht në disa zona.

- 3 (tre) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik do te realizojne organizimin e ekipeve të terrenit; kryerjen e matjeve; evidentimin e koordinatave; kontrollin e saktësisë së matjeve; përpunimin paraprak të informacionit etj. Numri prej tre specialistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë faktin qe paralelisht mund te kryhet sherbimi në disa zona administrative dhe kerkohet te garantohet vazhdimësia e shërbimit dhe perfundimi ne kohe.
- 1 (një) specialist të pajisur me certifikate të trajnimit kombëtarë ose ndërkombëtarë ne programet GIS ose programe ekuivalente . Certifikimi i kërkuara mund të zotërohet edhe nga stafi i sipërcituar. Specialisti me certifikimin e mesiper eshte i domosdoshem sepse procesi nuk ka vetem mbledhjen e te dhenave ne terren. Ky specialist eshte i domosdoshem per përpunimin, kontrollimin, integrimin, regjistrimin ne program etj te te dhenave.
- 4 (katër) specialiste agronomë. Specialistet agronome jane te domosdoshem per procesin sepse ata do te kryejne identifikimin biologjik të ullirit, verifikimin e gjendjes se pemeve te ullirit etj. Specialistet e mesiperm do të garantojnë që ky proces do te behet sipas termave te references.

Eshte parashikuar edhe mundesia qe stafi i mesiperm sipas piken 2.3.4 te mund te sigurohet edhe nepermjet kontrates se punes apo kontrates se bashkepunimit enkas per kete kontrate. Kjo rrit konkurencen dhe siguron gare te barabarte. Vetem ne rast se stafi i mesiperm do te jete i Operatorit Ekonomik pjesemarres, duhet të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit. Ne rast se stafi i mesiperm sigurohet nepermjet kontrates se punes apo kontrates se bashkepunimit, nuk eshte kusht perfshirja ne list pageze per muajin e fundit.

2.3.5 Një punësim mesatar prej **9 (nëntë) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa për stafin bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. Numri i përcaktuar është si rezultat i analizës së volumit të shërbimit, afatit të kontratës dhe organizimit minimal të nevojshëm për realizimin e saj. Ky kriter është në proporcion me objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkimi i listëpagesës së muajit të fundit dhe vërtetimit nga Administrata Tatimore synon të provojë se operatori ekonomik disponon ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të shërbimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a” është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku përcaktohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe

ne nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 e vlefshme / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Kjo ISO konsiderohet e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e shërbimit që do të realizohet.

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 2(dy) mjete transporti;
- 1(nje) dron profesional;

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe ne nenin 41, pika 4 gërma (ç) ku parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Për përcaktimin e pajisjeve dhe makinerive të kërkuara, argumentohet se është bazuar në shërbimet e parashikuara sipas Termave të Referencës. Vendosja e këtij kriteri është bërë në përputhje me nevojën për realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin, duke përfshirë sigurimin e mjeteve të domosdoshme si automjetet për lëvizjen në terren, sepse shërbimi do të realizohet në 16 njësi administrative të shpërndara në territorin e Qarkut Fier, ku distancat ndërmjet zonave të punës janë të konsiderueshme. Pajisjen dron , të cilat garantojnë kryerjen e saktë dhe efikase të verifikimeve në terren, dhe identifikimit për realizimin e shërbimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të LPP 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Loti 2: “Studim fushor për identifikimin, regjistrimin dhe dixhitalizimin në programin “Kadastra e Ullirit” e 5500 (pesë mijë e pesëqind) njësi të reja të ullirit” në njësitë administrative: Shushicë, Kotë, Himarë, Vlorë dhe Selenicë në qarkun Vlorë”.

Autoriteti Kontraktor ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit duke u bazuar në analizën teknike të objektit të kontratës, vlerën e fondit limit, afatin e realizimit, kompleksitetin e shërbimit, shtrirjen territoriale dhe rezultatet që synohen të arrihen.

Objekti i kontratës nuk përbën një shërbim administrativ të zakonshëm, por një aktivitet teknik dhe profesional që përfshin identifikimin në terren të njësive të ullirit, evidentimin e koordinatave gjeografike, përpunimin e informacionit, verifikimin teknik, administrimin e të dhënave gjeohapësinore dhe regjistrimin e tyre në sistemin “Kadastra e Ullirit”.

Shërbimi do të realizohet në 5 njësi administrative të Qarkut Vlorë, me evidentimin e 5500 njësive të reja të ullirit, çka kërkon organizim paralel të ekipeve në terren, koordinim teknik, kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së të dhënave dhe respektim të afateve kontraktore.

Për këtë arsye, kriteret e vendosura janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e saj.

Kriteret janë hartuar në mbështetje të: Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar; parimeve të proporcionalitetit, mosdiskriminimit, transparencës dhe konkurrencës, të parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10**;

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023,2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontrates, per Lotin e dyte.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit të parë, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit të Lotit të dyte.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar

kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara dhe duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

Kontrata parashikon evidentimin e 5500 njësive të reja të ullirit në një territor të gjerë, me karakteristika të ndryshme topografike dhe administrative. Për këtë arsye, realizimi i kontratës kërkon kapacitete organizative dhe teknike të provuara më parë.

Paraqitja e pervojës së ngjashme të realizuara si me sektorin publik ashtu edhe me sektorin privat garanton respektimin e parimit të trajtimit të barabartë dhe zgjeron mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

8. PROJEKTUES GJEODET

- b- Rilevime inxhinierike kadastrale
- c- Sistemet GIS
- e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë liçencën profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore. Kategoria e kërkuar e liçencës është kërkuar bazuar në natyrën e shërbimit të kërkuar dhe termave të referencës të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor përfitues e cila shërben për të rritur besueshmërinë dhe sigurinë që produkti final do të jetë në përputhje me kërkesat dhe objektin ku konkretisht kërkohet: Identifikimi në terren i njësive të ullirit, përcaktimi i pozicionit të tyre gjeografik, administrimi i koordinatave, përpunimi i informacionit gjeohapësinor dhe regjistrimi i të dhënave në sistemin "Kadastra e Ullirit". Këto procese kërkojnë njohuri të specializuara në fushën e gjeodezisë, hartografisë, fotogrametrisë dhe sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).

- Nënkatëgoria "Rilevime inxhinierike kadastrale" është e domosdoshme për evidentimin dhe përcaktimin korrekt të pozicionit të objekteve në terren.
- Nënkatëgoria "Sistemet GIS" lidhet drejtpërdrejt me përpunimin, administrimin dhe integrimin e të dhënave gjeohapësinore në platformën "Kadastra e Ullirit", e cila funksionon mbi bazën e sistemeve të informacionit gjeografik.

- Nënkatëgoria "Projektim fotogrametrik dhe hartografik" është e nevojshme për interpretimin dhe përpunimin e materialeve kartografike dhe ortofotove që përdoren gjatë procesit të identifikimit dhe verifikimit të njësive të ullirit.

2.3.3 Operatori/ët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për muajt e fundit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik

Për stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektivit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i procedurës nuk konsiston vetëm në evidentimin fizik të njësive të ullirit, por përfshin edhe aktivitete të specializuara të karakterit gjeodezik dhe gjeohapësinor, të cilat kërkojnë drejtim teknik nga një specialist i fushës. Për këtë arsye, vlerësohet se prania e të paktën një inxhinieri të kësaj fushe është kusht minimal dhe proporcional me objektin e kontratës. Kërkesa që ky specialist të jetë i punësuar dhe të paraqitet kontrata e punës, diploma dhe CV-ja synon të garantojë disponueshmërinë reale të ekspertit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Inxhinieri i diplomuar në një nga fushat e mesipërme garanton dhe është përgjegjës i organizimit teknik të punimeve; metodologjisë që do të ndiqet për mbledhjen e të dhënave; do të koordinojë punën e ekipeve në terren; etj kontrollin teknik të matjeve; kontrollin e cilësisë së të dhënave përpara regjistrimit në sistemin "Kadastra e Ullirit" etj.

2.3.4. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontratë pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik
- 1 (një) specialist të pajisur me certifikate të trajnimit kombëtarë ose ndërkombëtarë në programet GIS ose programe ekuivalente . Certifikimi i kërkuar mund të zotërohet edhe nga stafi i sipërcituar.
- 2 (dy) specialiste agronomë

Për stafin e mesipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV.

Në rast se stafi i mesipërm do të jetë i OE pjesëmarrës, duhet të figurojnë në listat e shoqërisë për muajt e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i kontratës përfshin evidentimin e 5500 njësive të reja të ullirit, të shpërndara në 5 njësi administrative të Qarkut Vlore, me distanca të konsiderueshme ndërmjet tyre dhe me karakteristika të ndryshme të relievit. Për të respektuar afatin e përcaktuar nga AK përfituese, është e domosdoshme që aktiviteti të zhvillohet njëkohësisht në disa zona.

- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Gjeoinformatik/Gjeomatik do të realizojnë organizimin e ekipeve të terrenit; kryerjen e matjeve; evidentimin e koordinatave; kontrollin e saktësisë së matjeve; përpunimin paraprak të informacionit etj. Numri prej dy specialistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë faktin që paralelisht mund të kryhet shërbimi në disa zona administrative dhe kërkohet të garantohet vazhdimësia e shërbimit dhe përfundimi në kohe.
- 1 (një) specialist të pajisur me certifikate të trajnimit kombëtarë ose ndërkombëtarë në programet GIS ose programe ekuivalente. Certifikimi i kërkuar mund të zotërohet edhe nga stafi i sipërcituar. Specialisti me certifikimin e mesipër është i domosdoshëm sepse procesi nuk ka vetëm mbledhjen e të dhënave në terren. Ky specialist është i domosdoshëm për përpunimin, kontrollimin, integrimin, regjistrimin në program etj të të dhënave.
- 2 (dy) specialiste agronomë. Specialistet agronomë janë të domosdoshëm për procesin sepse ata do të kryejnë identifikimin biologjik të ullirit, verifikimin e gjendjes së pemëve të ullirit etj. Specialistet e mesipër do të garantojnë që ky proces do të bëhet sipas termave të referencës.

Është parashikuar edhe mundësia që stafi i mesipër sipas pikës 2.3.4 të mund të sigurohet edhe nëpërmjet kontratës së punës apo kontratës së bashkëpunimit enkas për këtë kontratë. Kjo rrit konkurrencën dhe siguron garë të barabartë. Vetëm në rast se stafi i mesipër do të jetë i Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, duhet të figurojnë në listat e shoqërisë për muajin e fundit. Në rast se stafi i mesipër sigurohet nëpërmjet kontratës së punës apo kontratës së bashkëpunimit, nuk është kusht përfshirja në listat e pagesave për muajin e fundit.

2.3.5 Një punësim mesatar prej **6 (gjashtë) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa për stafin bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. Numri i përcaktuar është si rezultat i analizës së volumit të shërbimit, afatit të kontratës dhe organizimit minimal të nevojshëm për realizimin e saj. Ky kriter është në proporcion me objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkimi i listëpagesës së muajit të fundit dhe vërtetimit nga Administrata Tatimore synon të provojë se operatori ekonomik disponon ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- b) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001-2015 e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të shërbimeve që ka marrë për të realizuar.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a” është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku përcaktohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001:2015 e vlefshme / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Kjo ISO konsiderohet e

lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e shërbimit që do të realizohet.

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 2(dy) mjete transporti;
- 1(nje) dron profesional;

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4 gërma (ç) ku parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Për përcaktimin e pajisjeve dhe makinerive të kërkuara, argumentohet se është bazuar në shërbimet e parashikuara sipas Termave të Referencës. Vendosja e këtij kriteri është bërë në përputhje me nevojën për realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin, duke përfshirë sigurimin e mjeteve të domosdoshme si automjetet për lëvizjen në terren, sepse shërbimi do të realizohet në 16 njësi administrative të shpërndara në territorin e Qarkut Vlore, ku distancat ndërmjet zonave të punës janë të konsiderueshme. Pajisjen dron , të cilat garantojnë kryerjen e saktë dhe efikase të verifikimeve në terren, dhe identifikimit për realizimin e shërbimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e

origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “*Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise*”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të LPP 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT